

# Raport

**Nga pjesëmarrja në punëtorinë “Trashëgimia Kulturore e Vushtrrisë - sfidat dhe mundësitë”**

Organizator: Fondacioni Suedez Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)  
Të përkrahur nga: Kuvendi komunal Vushtrri  
Pjesëmarrësit: Pjesëmarrës nga CHwB, Universiteti i Prishtinës, shoqëria civile e Vushtrrisë, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Qendra Rajonale për Trashëgimi kulturore – Mitrovicë, OJQ-të nga komuna e Vushtrrisë, Drejtoria e Urbanizmit – Vushtrri, ICO, MMPH/IPH, Muzeu komunal – Vushtrri,  
Vendi: Vushtrri, Novo Bërdë dhe Hoçë e Madhe  
Data: 16 – 19.04.2011

---

## Qëllimi i punëtorisë

Projekti i intervenimeve emergjente në Kalanë e Vushtrrisë është finansuar nga Fondi i Ambasadorëve të SHBA-ve dhe është duke u implementuar nga CHwB.

Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë, përfshirja sa më e madhe dhe më gjithëpërfshirëse e pjesëmarrësve nga institucionet e nivelit qendror, lokal, organizatat ndërkombëtare, lokale si dhe nga shoqëria civile kryesisht të komunës së Vushtrrisë, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte janë të involvuar në fushën e trashëgimisë kulturore. Përmes projektit të “Kalasë së Vushtrrisë” dhe modeleve të propozuara në kontekst të zhvillimit të turizmit rural, në disa fshatra të komunës së Novobërdës dhe fshatit Hoçë e Madhe (modeli – shtrat dhe mëngjes ), dhe përmes vizitës në terren të këtyre anëve - të shkëmbehen informatat dhe idetë për të trajtuar dhe avancuar më tej çështjen e trashëgimisë kulturore në komunën e Vushtrrisë në përgjithësi, dhe në veçanti hulumtimin e mundësive dhe ofrimin e zgjidhjeve për shfrytëzimin e Kalasë dhe potencialeve që ofron ky monument i rëndësishëm kulturor.

## Ligjëratat

Projekti i kalasë së Vushtrrisë- Alfredo Navarro  
Hyrje në parimet e trashëgimisë kulturore – Crystal Whitaker  
Turizmi i integruar bazuar në trashëgiminë kulturore – Enes Toska (CHwB)  
Trashëgimia kulturore e Vushtrrisë – Shukrane Begu (Muzeu i Vushtrrisë)  
Rasti i studimit të Novobërdës – Fitim Bunjaku (Qendra Informative-Novobërdë)



## Vizita në terren

Është vizituar qyteti i Vushtrrisë dhe janë vizituar disa monumente me trashëgimi kulturore si: Ura e vjetër e gurit, Hamami i Vushtrrisë, Kalaja etj.



Është vizituar Kalaja e Novobërdës me objektet përcjellëse rreth saj.



Është vizituar fshati i Hoçës së Madhe, karakteristike e së cilës janë një numër i madh i shtëpive tradicionale si dhe numër i madh i kishave në një territor relativisht të vogël.



### Rezultatet e punëtorisë

Modeli i punëtorisë ka qenë me punë grupore, prezantime, diskutime, komente, debate dhe propozime, të cilat në fund rezultuan me:

- SWOT – analizë për trashëgiminë kulturore për komunën e Vushtrrisë;
- Definimin e Projekteve/ aksioneve/ aktiviteteve në temat si:
  - Mbrojtja e monumenteve
  - Integrimi i trashëgimisë kulturore në jetën moderne
  - Zhvillimi lokal i bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore
- Harta e memories për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Vushtrrisë.



Me respekt,

**Festa Nixha-Nela**

**Elvida Pallaska**

**Arbën Rrecaj**

Instituti për Planifikim Hapësinor

MMPH